



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E KULTURËS DHE ARSIMIT

Nr. 5253 Prot.

Roskovec, më 10.07. 2026

PROJEKT-VENDIM

NR. __, DATË 10.07. 2026

PËR

DHËNIEN E TITULLIT "QYTETAR NDERI" TË BASHKISË ROSKOVEC

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, përkatësisht nenit 9 pika 1.7, gërma a), nenit 54 pika m); të Ligjit nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", nenit 8, nenit 9 pika 1, nenit 11 pika 2, nenit 13; si dhe të VKM-së nr. 861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënie e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë";

Ju paraqesim për diskutim dhe miratim:

- Propozimin për Dhënie e Titullit "Qytetar Nderi" të Bashkisë Roskovec, si më poshtë:
 - Shamet Latif Faria** me motivacionin: *"Për kontributin e tij në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, për shërbimin me përkushtim në fushën e mbrojtjes dhe për veprimtarinë e tij si agronom, duke dhënë një kontribut të çmuar në zhvillimin e bujqësisë dhe në shërbim të interesit publik"*.
- Pas miratimit të këtij projekt-vendimi në Këshillin e Bashkisë, ngarkohet Komisioni Këshillimor për dhënie e titujve vendorë të nderit për kryerjen e procedurave përkatëse.

Konceptoi: B.Cjapi

Konfirmoi: M.Goga

Për Drejtorinë Juridike: V.Zeqo

Sasia e ekzemplarëve të shtypur: 3 (tre)

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVENDËSKRYETARI

Maksim Goga

KRYETARI

Majlinda Bufi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

Nr. 823/1 prot

Roskovec, më 10.07. 2026

Lënda: Relacion mbi projekt-vendimin për dhënien e titujve "Qytetar Nderi" qytetarëve të Bashkisë Roskovec

KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC
Roskovec

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, përkatësisht neni 9 pika 1.7 gërma a), neni 54 pika m); neni 8, neni 9 pika 1, neni 11 pika 2, neni 13 i Ligjit nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë"; VKM-së nr.861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medalieve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë";

Kryetari i Bashkisë Roskovec ka paraqitur propozimin për dhënien e Titujve Vendorë të Nderit "Qytetar Nderi" i Bashkisë Roskovec për personalitetin e shquar të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në Bashkinë Roskovec për çështen kombëtare dhe luftën Nacional-Çlirimtare duke e shoqëruar me jetëshkrimin (biografinë) dhe dokumentacionin përkatës.

Propozimi kaloi për shqyrtim në Komisionin Këshillimor për dhënien e titujve vendorë të nderit, të ngritur me Urdhër të Brendshëm të Kryetares së Bashkisë Nr. 36, datë 05.03.2024 "Për krijimin e komisionit këshillimor për dhënien e titujve vendor të nderit".

Paraqesim për diskutim dhe miratim projekt-vendimin për Dhënien e Titujve "Qytetar Nderi" qytetarëve të Bashkisë Roskovec, konkretisht:

1. Shamet Latif Faria

Shamet Latif Faria u lind më 5 maj 1925 në fshatin Kurjan dhe po aty në periudhën 1936-1941, kreu shkollën fillore .

Ndërkohë, për të ndihmuar familjen punonte si bari, një detyrë e rëndë për një fëmijë, por që ai e përballoi me përgjegjësi e përkushtim.

Qysh atëherë, ai tregoi pjekuri dhe ndjenja të larta solidariteti.

Në vitin 1943, në moshën vetëm 18-vjeçare ai iu bashkua Luftës Nacionalçlirimtare.

U rreshtua në Brigadën e 10 Sulmuese, ku shërbeu deri në fund të luftës duke dhënë kontribut të drejtpërdrejtë në çlirimin e vendit.

Për guximin dhe angazhimin e tij, Shameti u lavdërua disa herë dhe u dekorua me disa nga nderimet më të larta të kohës, përfshirë:

- Dekoraten e Çlirimit
- Dekoraten e Trimërisë
- Dekoraten e 10-vjetorit të Ushtrisë
- Yllin e Kuq

Pas luftës, ai nuk u ndal.

Me të njëjtin përkushtim, ndoqi shkollën ushtarake në Tiranë ku u përgatit profesionalisht për të shërbyer në radhët e ushtrisë shqiptare.

Nga viti 1944 deri në 1955 shërbeu si oficer në rrethet Pogradec, Gjirokastrë dhe Leskovik duke qenë një figurë e respektuar në strukturat ushtarake të vendit.

Pas karrierës ushtarake, kaloi në fushën e administrimit dhe bujqësisë.

Nga 1955 deri më 1957 punoi si nën/drejtor i grumbullimit në Roskovec, ndërsa në vitet 1957-1959, u emërua kryetar i kooperativës në Kurjan duke rikthyer energjitë e tij në shërbim të fshatit të lindjes.

Në vitet 1960-1964, ndoqi studimet në fushën e agronomisë dhe me vendim të komisionit shtetëror të datës 17 shkurt 1964, iu dha titulli Agronom i Lartë.

Kjo diplomë ishte kurorëzimi i përpjekjeve të tij për t'u formuar si specialist i zoti në bujqësi, në një kohë kur vendi kishte nevojë jetike për zhvillimin e sektorit rural.

Nga viti 1961 deri më 1971 Shameti ushtroi detyrën e kryetarit të kooperativës së bashkuar, duke drejtuar me kompetencë dhe ndershmëri disa fshatra të zones.

Në vitin 1970, për kontributin e tij të vazhdueshëm dhe figurën e respektuar që kishte ndërtuar, u propozua për deputet një vlerësim që tregonte besimin që komuniteti dhe partia kishin tek ai.

Në vitet 1972-1973, ai shërbeu si nëndrejtor i Ndërmarrjes së Grumbullimit në Fier, ndërsa më pas në 1973-1975 u rikthye si kryetar i kooperativës në Libofsh ku vijoi me përkushtim.

Në vitin 1975 u kthye në Kurjan si agronom,

një profesion që e ushtronte me pasion dhe përkushtim deri në vitin 1982 kur doli në pension.

Edhe pas pensionit, ai mbeti një këshilltar dhe figurë orientuese për komunitetin bujqësor lokal.

Kudo ku ka punuar, Shamet Faria është dalluar për korrektësi, ndershmëri dhe sinqeritet.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin !

Konceptoi: B. Cjapi

Konfirmoi: M. Goga

K R Y E T A R
Majlinda Bufi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDESKRYETAR

Maksim Goga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETITIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 1376/3 Prot.

Tiranë, më 09. 07. 2026

Lënda: Informim mbi rezultatin e verifikimit të pastërtisë së figurës për kandidatin e propozuar për vlerësimin me “Tituj Nderi”.

BASHKISË ROSKOVEC

Adresa: Sheshi "Qendër Roskovec"

Të nderuar !

Në përgjigje të shkresës Suaj nr. 4572 prot., datë 18.06.2026, “Kërkesë për informacion”, drejtuar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti), për verifikimin e figurës së kandidatit z. Shamet Latif Faria në kuadër të vlerësimit me titullin “Qytetar Nderi i Bashkisë Roskovec”, bashkëlidhur do të gjeni:

Vendimin nr. 357, datë 09.07.2026 të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Sofi Nok





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Nr. 1532/14 Prot.

Tiranë, më 08.07.2026

V E N D I M

Nr. 357 Datë 08.07.2026

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e datës 08.07.2026, me pjesëmarrjen e anëtarëve:

Znj. Gentiana Sula	Kryetare
Z. Albert Nikolla	Anëtar
Z. Altin Hoxha	Anëtar
Z. Skënder Vrioni	Anëtar



shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT:

Kërkesa e paraqitur nga Institucioni i Bashkisë Roskovec, me shkresën nr. nr. 4572 prot., datë 18.06.2026, "Kërkesë për informacion", për verifikimin e figurës së z. Shamet Faria, kandidat i propozuar për dhënien e titullit "Qytetar nderi i qytetit".

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar.

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, pasi shqyrtoi kërkesën për informacion të paraqitur nga Institucioni i Bashkisë Roskovec, me shkresën nr. nr. 4572 prot., datë 18.06.2026, sipas objektit të saj,

V Ë R E N:

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar, është përgjegjës për zbatimin e ligjit, lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to.

Në nenin 10, pika "dh" të Ligjit nr. 45/2015, një nga detyrat e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit është edhe informimi i individëve, institucioneve kushtetuese, autoriteteve publike dhe subjekteve të tjera të interesuara, sipas këtij ligji.

Nga përmbajtja e shkresës nr. 4572 prot., datë 18.06.2026, "Kërkesë për informacion", Institucioni i Bashkisë Roskovec, në zbatim të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar, i ka kërkuar Autoritetit nëse disponon informacion, lidhur me z. Shamet Latif Faria si kandidat i propozuar për dhënien e titullit të nderit "Qytetar nderi i qytetit", me përmbajtje sipas shkresës së dërguar nga Bashkia Roskovec.

Mbi bazën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë, si dhe nga verifikimet e kryera deri tani referuar të dhënave të paraqitura nga institucioni kërkues, z. Shamet Latif Faria, nuk figuron të ketë materiale në emër të tyre, sipas Nenit 30, të Ligjit Nr. 45/2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 10, nenin 26 e vijues të ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike", Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

VENDOSI :

1. Të informojë Institucionin e Bashkisë Rockovec për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 4572 prot., datë 18.06.2026 "Kërkesë për informacion", në kuadër të propozimit për titull nderi, se nga verifikimet e kryera deri tani, sipas përcaktimeve të nenit 30 të Ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit", i ndryshuar rezulton se z. Shamet Faria:

- a) Nuk ka qenë anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm, Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme, anëtar i Këshillit të Ministrave, kryetar i degëve të punëve të brendshme, anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim Internimeve, hetues, prokuror, gjyqtar në procese posaçme politike, apo punonjës i nivelit të lartë i ish-Sigurimit të Shtetit;
- b) Nuk ka qenë bashkëpunëtor të ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, denoncues në proceset politike ose dëshmitar i akuzës në proceset politike të posaçme, pas mbushjes së moshës 18 vjeç;
- c) Nuk ka qenë person me të dhëna nga ish-Sigurimi i Shtetit për spiunazh dhe terrorizëm.

2. Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet institucionit të Bashkisë Rockovec

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit.



ANËTAR

Dr. Albert Nikolla

ANËTAR

Alfin Hoxha

ANËTAR

Skënder Vrioni